



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 219/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “*Shërbim me roje private ” i ambienteve të ISHP-së – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

**Ankimues:** “Trezhnjeva” shpk.  
Adresa: Bulevardi i Dafinave, ish-fusha e aviacionit, G.22, P.2 K.III, Ap.9, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Instituti i Shëndetit Publik.  
Adresa: Rruga “Aleksandër Mosiu”, Nr.80, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.06.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “*Shërbim me roje private ” i ambienteve të ISHP-së – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

II.2. Në datën 05.06.2020, operatori ekonomik ankimues “*Trezhnjeva*” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kërkesat për kualifikim e konkretisht:

[...]

*Në datën 02.06.2020, nëpërmjet SPE, jemi njohur me dokumentat e tenderit.*

*Nga verifikimi i tyre konstatoam se ato janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike, pasi janë diskriminuese, për rrjedhojë përjashtuese si dhe lënë vend për interpretim dhe keqinterpretim.*

*Madje nga leximi me kujdes i tyre, konstatojmë se kemi të bëjmë me rastin tipik kur gara është paracaktuar/fiksuar se kujt operatori do ti jepet. Dalim në këtë konkluzion, pasi të gjitha kriteret lidhen ngushtësisht me kapacitetet që disponon shoqëria e cila ruan aktualisht në vëndrojen objekt prokurimi.*

*Konkretisht: Kriteret e vendosura shmangin pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe për pasojë shmang konkurrencën dhe barazinë në tendera publike.*

*Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-neë dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik,*
- g) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*Në Shtojca 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, autoriteti ka publikuar shënimin si në vijim:*

### **Shtojca 1**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]*

### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

*Emri i Ofertuesit\_\_\_\_\_*

*Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

*\* \* \**

*Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]*

*Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]*

*Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

*\* \* \**

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

- 1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;*
- 2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH*

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Shërbimeve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia (nr.vendroje</b>	<b>Numri total i rojeve për</b>	<b>Çmimi Njësi</b>	<b>Oferta në total</b>

		<i>(Muaj)</i>	<i>ve)</i>	<i>vendroje</i>	<i>/muaj për një roje</i>	<i>(neto)</i>
1.	<i>Sherbimi i ruajtjes te porta kryesore e ISHP-se per 1 vend roje me 3 turne</i>	<b>12</b>	<b>1</b>	4.98	<b>(X)</b>	<b>(X)</b>
2.	<i>Sherbimi i ruajtjes te sektori i Vivariumit te ISHP-se per 1 vend roje me 3 turne</i>	<b>12</b>	<b>1</b>	4.98	<b>(X)</b>	
3.	<i>Sherbim i ruajtjes se godines Qendrore te ISHP-se me 1 turn(turn i pare)</i>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>(X)</b>	
	<b>Oferta Neto ne total</b>					
	<b>TVSH (%)</b>					<b>(X)</b>
	<b>Oferta total</b>					<b>(X)</b>

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

### **Sqarime**

1. Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, dhe per 1 roje dhe nje vend roje me 1 turn sipas tabelave të mëposhtme.

**Tabela 1: Përlllogaritja për një vendroje me tre turne**

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Vlera (Lek) 1 roje /muaj</b>	<b>Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /muaj</b>
<b>1</b>	<i>Shpenzime per page baze</i>		
<b>2</b>	<i>Shtese mbi page per turn II</i>		
<b>3</b>	<i>Shtese mbi page per turn III</i>		

4	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore 16.7%		

**Tabela 2: Përlllogaritja për një për 1 vendroje pozicion gjatë orarit zyrtar**

Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) I roje /muaj	Vlera (Lek) I vendroje me nje turn(turn i pare) /dite
1	Shpenzime per page baze		
2	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore 16.7%		

**Analiza e kostos**

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 809, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore)**. Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar ne dokumentat e tenderit ).
- **Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.**

Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë saktë se mbi cilën bazë mujore do të llogariten ofertat me mesataren mujore 30.5 ditë si vit i brishtë apo me mesataren mujore 30.41 ditë/muaj, pasi kemi të bëjmë me 365 ditë shërbim dhe nuk parashikohet shërbim në muajin shkurt që është muaji i brishtë.

Kërkojmë të përcaktohet mesatarja mujore me 30.41 ditë pasi ky konfuzion që krijohet sjell ofertues me oferta të ndryshme dhe bëhen shkak për ankimime.

2.3 Kapaciteti teknik pika 3 "Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik". Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut

*Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.*

*Kërkojmë t'i hiqet pjesa: "Të mos ketë masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik."*

*Kërkesa e mësipërme ku kërkohet: "Të mos ketë marrë masë administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik është një kërkesë që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe bie ndesh me parimet e LPP-së.*

*Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërmat "a", "b" dhe "c", parashikohet si më poshtë: "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe/ose...]"*

*Shoqëria jonë gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2 të LPP, i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik,*
- g) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*Shoqëria jonë gjykon se kërkesa e referuar më sipër është diskriminuese, pasi nuk sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë si ata që kanë masa administrative dhe ata që nuk kanë masa administrative.*

*Legjislacioni i prokurimit publik i ka përcaktuar qartë rastet kur një operator mund të përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi dhe ky rast nuk është i përfshirë.*

*Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e kërkesës që ka të bëjë me “për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik) pasi në vërtetimin e performancës vetë organi i policisë shtetit shprehet për vlerësimin pozitiv ose negativ të operatorit ekonomik.*

*Përfundimisht kërkojmë:*

- 1. Pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e plotë të ankesës;*
- 2. Modifikimin e DST*
- 3. Kthim përgjigje brenda afatit të përcaktuar në nenin 63 të LPP-së.*

*II.3. Në datën 08.06.2020, nëpërmjet shkresës nr.630/9 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k, duke pranuar një prej pretendime të tij si më poshtë:*

*Në përgjigje të ankesës suaj datë 03.06.2020 (prot në ISHP me nr. 630/5 prot, datë 05.06.2020,) me objekt ankimim për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim me roje private” me fond limit në total: 6 864 034.83 (gjashtëmilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e tridhjetë e katër pikë 83) lekë pa TVSH, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i ngritur me urdhrin nr. 630/7, datë 05.06.2020, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, vëren se:*

*I.1.Pas shqyrtimit të ankesës, së operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstatoi se ankimuesi legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me procedurën e prokurimit të mësipërme, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.*

*I.2. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore për depozitimin e ankimit sipas nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 78 të VKM-së nr.914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, pranë autoritetit kontraktor.*

*I.3. Autoriteti kontraktor bazuar sa më sipër vendosi pezullimin e procedurës me shkresën nr. 630/6, datë 05/06/2020 dhe emëroi me shkresën nr. 630/7, datë 05.06.2020, Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, për shqyrtimin e ankesës të përbërë nga: 1. Adrian Lito 2.Kreshnik Petrela 3.Fuat Toptani.*

*Përsa i përket pretendimit tuaj në lidhje me përcaktimin e saktë nga AK se mbi cilën bazë mujore do të llogaritet oferta me mesataren 30.5 ditë si vit i brishtë apo me mesataren mujore 30.41 ditë në muaj, pasi kemi të bëjmë me 365 ditë shërbim dhe nuk parashikohet shërbim për muajin shkurt që është muaj i brishtë.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon se procedura do të mbulojë periudhën e gjysmës së dytë të vitit 2020 dhe gjysmën e parë të vitit 2021 nuk ka vend për diskutim se mbi çfarë baze do të përlllogariten mesatarja ditë/muaj.*

*Ju sjellim në vëmendje që viti 2021 nuk është vit i brishtë dhe mesatarja mujore mbi të cilën llogariten është 30.41ditë/muaj bazuar në rekomandimet e APP dhe KPP.*

*Përsa i përket pretendimit tuaj në lidhje me vendosjen nga AK në dokumentat standarte të tenderit tek kriteret e veçanta për kualifikim në pikën 3 ku kërkohet “Dokumenti i performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë “Vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky information dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.”.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomike të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Kriteri i vendosur për mospasjen e shkeljeve dhe masave nga ana e operatorëve ekonomikë gjatë veprimtarisë së tyre nuk përbën në vetvete një kriter diskriminues dhe nuk i tejkalon përmasat e kontratës së prokuruar. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kritere ndaluese për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbushjes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte të tjera ligjore e nënligjore. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit. Sa më lart, Komisioni i shqyrtimit të ankesës njëzëri*

*Vendos:*

*Të mos pranojë ankesën e OE “SHPSF Trezhnjeva” për procedurën e prokurimit “Shërbim me Roje Private” me fond limit në total: 6 864 034.83 (gjashtëmilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e tridhjetë e katër pikë 83) lekë pa-TVSH, që do të zhvillohej më datë 16/06/2020 nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik në [vëë.app.gov.al](http://vëë.app.gov.al).*

**II.4. Në datën 16.06.2020 operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k, ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke zvogëluar objektin e ankesës si më poshtë vijon:**

*Në bazë të nenit 63/6 të ligjit nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, po paraqesim këtë ankim duke parashtruar si vijon: SHPSF “Trezhnjeva” shpk paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me publikimin e DST më datën 02.06.2020, në*



procedurën e mësipërme ku kemi parashtruar faktet, argumentat dhe provat përkatëse, si dhe vendimit të autoritetit kontraktor nr.630/9, datë 08.06.2020, ku ka pranuar pjesërisht ankesën tonë vetëm sqarimin për përgatitjen e formularit të ofertës, janë bërë në kundërshtim me ligjislacionin në fuqi në lidhje me kriteret kualifikuese. Nga verifikimi i tyre konstatoam se ato janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike, pasi janë diskriminuese, për rrjedhojë përjashtuese si dhe lënë vend për interpretim dhe keqinterpretim.

Madje nga leximi me kujdes i tyre, konstatojmë se kemi të bëjmë me rastin tipik kur gara është paracaktuar/fiksuar se kujt operatori do t'i jepet. Dalim në këtë konkluzion pasi kriteret lidhen ngushtësisht me kapacitetet që disponon shoqëria e cila ruane aktualisht në vëndrojen objektin e prokurimit.

Konkretisht;

Përsa i përket pikës së parë për mënyrën e llogaritjes së ofertës autoriteti ka bërë sqarimin e plotë dhe nuk e ankimojmë në KPP.

Kundërshtojmë kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik pika 3.

Në dst kërkohet: “Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.”.

Kemi kërkuar heqjen e këtij kriteri por autoriteti kontraktor në kthim përgjigje pretendon se citoj; “Autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterit të sipërcituar kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Kriteri i vendosur “nuk duhet të ketë masa administrative për shoqërinë, për titullar subjekti, për drejtuesin teknik, për punonjës shërbimi gjatë ushtrimit të aktivitetit për vitin 2018 - 2019”, nuk përbën në vetvete një kriter diskriminues dhe nuk i tejkalon përmasat e kontratës së prokuruar. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kriteret ndaluese për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbushjes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte të tjera ligjore e nënligjore. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.”.

*Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërmat “a”, “b” dhe “c”, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe/ose...]”.*

*Shoqëria jonë gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2 të LPP, i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik,*
- g) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*Shoqëria jonë gjykon se kërkesa e referuar më sipër është diskriminuese, pasi nuk sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë si ata që kanë masa administrative dhe ata që nuk kanë masa administrative. Ky kriter nuk përcakton kohën se nga cila datë operatori ekonomik nuk duhet të ketë masa administrative po kështu dhe informacionin për masa administrative e kërkon vetëm nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë kur performanca e një subjekti që ushtron aktivitetin në kategorinë 1.3 A nuk shtrihet vetëm në Tiranë, por ku e ushtron aktivitetin në gjithë territorin e Republikës Shqipërisë.*

*Po kështu ky kriter është përjashtues dhe diskriminues pasi heq nga gara ato subjekte që kanë gjoba në Tiranë dhe nuk merr informacion për gjobat që kanë operatorët ekonomikë në qarqe të tjera për operatorin ekonomik, titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik dhe këto subjekte nuk përjashtohen nga gara.*

*Lind pyetja: Operatorët ekonomikë që kanë gjobë në qarqet e tjera por nuk kanë në Tiranë dhe konkuron në këtë procedurë prokurimi a e kanë të njëjtën garanci në lidhje me përmbushjen me*

*sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, (panvarësisht se në cilin qark është marrë gjoba, drejtuesi teknik është i njëjti).*

*E kuptojmë që është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kritere ndaluese për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbushjes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte të tjera ligjore e nënligjore. E kuptojmë se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të veërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E kuptojmë që për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit. Ne në rastin konkret të kësaj procedure kërkesa e AK është më shumë përjashtuese se sa të pranoj operatorë ekonomikë me performancë pozitive.*

*Kujtojmë se sipas këtij kriteri AK duhej të kërkonte performancë nga operatorët ekonomikë nga të gjitha qarqet ku ushtron aktivitet për të vlerësuar performancën e subjektit, pasi subjektet janë të paisuar me licensë dhe certifikata të kategorisë 1.3 A dhe ushtrojnë aktivitet në të gjithë territorin e republikës dhe nuk ka si të ketë performancë pozitive një subjekt që ka marrë masa administrative në qarqe të tjera dhe nuk ka marrë masa administrative në Qarkun Tiranë ky kriter është përjashtues dhe nuk krijon barazi.*

*Kriteri i mësipërm është qëllimisht përjashtues pasi favorizon subjekte të veçanta edhe për faktin se në kriter nuk kërkohet që Titullari i subjektit të mos ketë marrë masa administrative kjo për të favorizuar subjektet që kanë gjoba për titullarin dhe nuk kanë gjoba për drejtuesin teknik dhe për të larguar firmat që kanë gjoba për drejtuesin teknik. Të nderuar anëtarë të Kpp-së defekti i këtij kriteri janë si aromat i ndien vetëm ai që është afër, dhe jo ai që bart. Ku në rastin konkret është i qartë ky kriter ku favorizon firmën aktuale që ka objektin dhe ata që bashkëpunojnë në oferta me të. Autoriteti kontraktor duhej të vendoste kriteret si për të panjohur por në fakt është ndikuar dhe mënyra e justifikimit gjoja kërkojmë operatorë me performancë pozitive dhe pa masa administrative nuk qëndron sa e spjegova, por ai që shikon lojën, shef më shumë se lojtari.*

*Ne gjykojmë se përse i përket performancës duhet të merret parasysh vlerësimi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë ku është dhënë masa që tregon se subjekti ka punuar mire apo jo dhe a ka bashkëpunuar me drejtorinë e policisë pavarësisht masës së dhënë ose jo, ky vlerësim jep garancin për subjektin dhe stafin e saj drejtues. Vlerësimi i dhënë nga Drejtoria e Policisë Qarkut për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit dhe bashkëpunimin me policinë është garanci institucionale që i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin pozitiv të operatorit ekonomik.*

*Prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter duke kërkuar vetëm performancën e subjektit lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë e cila duhet të jetë e mirë dhe bashkëpunuese me policinë ose duhet të kërkohet vërtetim nga gjitha drejtorit e policisë së qarqeve ku ushtrohet aktivitetet për masat administrative që konkurimi të jetë i barabartë.*

*Si përfundim kërkojmë:*

*Së pari: Marrjen parasysh të ankesës tonë.*

*Së dyti: Pezullimin e procedurës deri në shqyrtim të plotë të ankesës tonë.*

*Së treti: Modifikimin e DST duke kërkuar vlerësimin pozitiv të performancës nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë dhe duke hequr pjesën e masave administrative ose duke kërkuar vërtetim nga të gjitha drejtoritë e Policisë së Qarqeve ku ushtron aktivitetet subjekti, duke përcaktuar dhe periudhën.*

II.5. Në datën 25.06.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 63/13 prot., datë 24.06.2020, protokolluar me tonën me nr. 577/2 prot, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Trezhnjeva*” sh.p.k, se: “*Kundërshtojmë kriterin e vendosur në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik pika 3.*

*Në dst kërkohet: “Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.”.*

*Kemi kërkuar heqjen e këtij kriteri por autoriteti kontraktor në kthim përgjigje pretendon se citoj; “Autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterit të sipërcituar kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Kriteri i vendosur “nuk duhet të ketë masa administrative për shoqërinë, për titullar subjekti, për drejtuesin teknik, për punonjës shërbimi gjatë ushtrimit të aktivitetit për vitin 2018 - 2019”, nuk përbën në vetvete një kriter diskriminues dhe nuk i tejkalon përmasat e kontratës së prokuruar. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kritere ndaluese për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbushjes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte*

të tjera ligjore e nënligjore. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.”.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërmat “a”, “b” dhe “c”, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe/ose...”.

Shoqëria jonë gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2 të LPP, i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik,

g) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Shoqëria jonë gjykon se kërkesa e referuar më sipër është diskriminuese, pasi nuk sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë si ata që kanë masa administrative dhe ata që nuk kanë masa administrative. Ky kriter nuk përcakton kohën se nga cila datë operatori ekonomik nuk duhet të ketë masa administrative po kështu dhe informacionin për masa administrative e kërkon vetëm nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë kur performanca e një subjekti që ushtron aktivitetin në kategorin 1.3 A nuk shtrihet vetëm në Tiranë, por ku e ushtron aktivitetin në gjithë territorin e Republikës Shqipërisë.

*Po kështu ky kriter është përjashtues dhe diskriminues pasi heq nga gara ato subjekte që kanë gjoba në Tiranë dhe nuk merr informacion për gjodat që kanë operatorët ekonomikë në qarqe të tjera për operatorin ekonomik, titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik dhe këto subjekte nuk përjashtohen nga gara.*

*Lind pyetja: Operatorët ekonomikë që kanë gjobë në qarqet e tjera por nuk kanë në Tiranë dhe konkuron në këtë procedurë prokurimi a e kanë të njëjtën garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, (panvarësisht se në cilin qark është marrë gjoba, drejtuesi teknik është i njëjti).*

*E kuptojmë që është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kritere ndaluese për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbushjes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte të tjera ligjore e nënligjore. E kuptojmë se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të veërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E kuptojmë që për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit. Ne në rastin konkret të kësaj procedure kërkesa e AK është më shumë përjashtuese se sa të pranoj operatorë ekonomikë me performancë pozitive.*

*Kujtojmë se sipas këtij kriteri AK duhej të kërkonte performancë nga operatorët ekonomikë nga të gjitha qarqet ku ushtron aktivitet për të vlerësuar performancën e subjektit, pasi subjektet janë të paisuar me licensë dhe certifikata të kategorisë 1.3 A dhe ushtrojnë aktivitet në të gjithë territorin e republikës dhe nuk ka si të ketë performancë pozitive një subjekt që ka marrë masa administrative në qarqe të tjera dhe nuk ka marrë masa administrative në Qarkun Tiranë ky kriter është përjashtues dhe nuk krijon barazi.*

*Kriteri i mësipërm është qëllimisht përjashtues pasi favorizon subjekte të veçanta edhe për faktin se në kriter nuk kërkohet që Titullari i subjektit të mos ketë marrë masa administrative kjo për të favorizuar subjektet që kanë gjoba për titullarin dhe nuk kanë gjoba për drejtuesin teknik dhe për të larguar firmat që kanë gjoba për drejtuesin teknik. Të nderuar anëtarë të Kpp-së defekti i këtij kriteri janë si aromat i ndien vetëm ai që është afër, dhe jo ai që bart. Ku në rastin konkret është i qartë ky kriter ku favorizon firmën aktuale që ka objektin dhe ata që bashkëpunojnë në oferta me të. Autoriteti kontraktor duhej të vendoste kriteret si për të panjohur por në fakt është ndikuar dhe mënyra e justifikimit gjoja kërkojmë operatorë me performancë pozitive dhe pa masa administrative nuk qëndron sa e spjegova, por ai që shikon lojën, shef më shumë se lojtari. Ne gjykojmë se përse i përket performancës duhet të merret parasysh vlerësimi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë ku është dhënë masa që tregon se subjekti ka punuar mire apo jo dhe a ka bashkëpunuar me drejtorinë e policisë pavarësisht masës së dhënë ose jo, ky vlerësim jep garancin për subjektin dhe stafin e saj drejtues. Vlerësimi i dhënë nga Drejtoria e Policisë Qarkut për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit dhe bashkëpunimin me policinë është garanci institucionale që i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin pozitiv të operatorit ekonomik.*

*Prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter duke kërkuar vetëm performancën e subjektit lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë e cila duhet të jetë e mirë dhe*

*bashkëpunuese me policinë ose duhet të kërkohet vërtetim nga gjitha drejtorit e policisë së qarqeve ku ushtrohet aktivitet për masat administrative që konkurimi të jetë i barabartë..”*  
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në dokumentat e tenderit të modifikuara, shtojca 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 2.3.3, është përcaktuar:

*“3. Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.”.*

III.1.2. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr. 964. Datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.”.*

III.1.4. Në nenin 38 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.75/2014 dt.10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikohet se: *“1. Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, jepen masa administrative. 2. Masat administrative jepen nga strukturat e Policisë së Shtetit.”.*

III.1.5. Në nenin 28 pika 2 “Kontratat e Shërbimeve” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi

dorëzimin e një dokumenti përmes të cilës vërtetohet se subjekti të mos ketë marrë masë administrative për subjektin dhe drejtuesin teknik, nuk është një kriter diskriminues dhe është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës. Është në të drejtën e autoriteteve kontraktore të vendosin ato kritere ligjore të cilat i paraqesin një panoramë të qartë këtij të fundit mbi kapacitetin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. E rëndësishme është që kriteret të mos jenë diskriminues dhe të ofrojnë një trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe të jenë në proporcion me natyrën e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private ” i ambienteve të ISHP-së – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 577 Protokoli, Datë 16.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**